

Bazuar në nenin 21 të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit të Kompanisë Rajonale Ujësjiellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, Kryeshefi Ekzekutiv, lëshon këtë:

VENDIM

- I. **ANULOHET**, Konkursi i publikuar me datë 12.06.2026 lidhur me pozitën **Shef/e i/e Kontrollës Mitrovicë/Vushtrri**
- II. **OBLIGOHET**, Zyra së Burimeve Njerëzore të njoftoj Kandidatët që kanë aplikuar lidhur me këtë vendim;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetimi

Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Rajonale Ujësjiellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë ka marrë vendim për anulimin e konkursit të publikuar më 12.06.2026 për pozitën **Shef/e i/e Kontrollës Mitrovicë/Vushtrri**.

Gjatë shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara për pozitën në fjalë, është konstatuar nevoja që kriteret e parapara në Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës të rishikohen dhe të harmonizohen me natyrën e punës, detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të kësaj pozite.

Rishikimi i kriterëve është i nevojshëm me qëllim që kushtet e kërkuara për pozitën të jenë të qarta, objektive dhe në përputhje me nivelin e përgjegjësisë dhe kompetencat e pozitës. Për të garantuar zhvillimin e një procedure të rregullt, transparente dhe të barabartë të rekrutimit, konkursi anulohet në tërësi. Pas përfundimit të rishikimit dhe harmonizimit të kriterëve përkatëse, për pozitën në fjalë do të zhvillohet procedurë e re e rekrutimit, në përputhje me aktet e brendshme të Kompanisë dhe legjislacionin në fuqi.

Bazuar në arsyet e lartcekura, është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Bashkim Kuri
Kryeshefi ekzekutiv
Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Mitrovica" Sh.A.

